



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2670/11 Prot.

Tiranë, më 17.10.2023

V E N D I M

Nr. 68 datë 17.10 2023

“““MBI
NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN E BORDIT TË
ADMINISTRIMIT ME Nr. 35 datë 21.10.2019 “MBI MIRATIMIN E
RREGULLORES FINANCIARE DHE E SHPËRNDARJES SË TË
ARDHURAVE TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS”DHE
MIRATIMIN E TRAJTIMIT FINANCIAR TË STAFIT ADMINISTRATIV
TË ANGAZHUAR NË MBARËVAJTJEN E QENDRËS SË TRAJNIMIT TË
VAZHDUAR DHE REALIZIMIN E MODULIT RAFTING NË
UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS””

Mbështetur në nenin 49, 81, të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL-të e RSH”, në Statutin e UST-së, neni 43 në Vendimin e Rektoratit nr. 21 datë 29.04.2022 “Për riorganizimin e Qendrës së Trajnimeve dhe Formimit të Vazhduar në Univeristetin e Sporteve të Tiranës, në Vendimin e Senatit Akademik nr 50 datë 13.05.2023, në Vendimin e Bordit të Administrimit Nr.35 datë 21.10.2019, “Mbi miratimin e rregulloreve financiare dhe e shpërndarjes së të ardhurave të Universitetit të Sporteve të Tiranës” neni 7, pika a), në Vendimin e Bordit të Administrimit Nr.40 datë 24.08.2022 “Miratimin e tarifës për kredit, për modulet e trajnimeve”, Shkresës nr.2620/1 prot datë 18.04.2019 mbi kërkesën për akreditim programi të Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit, në Vendimin nr.10 datë 10.03.2023 të FVFR “Për hapjen e kursit profesional të Udhërrëfyesit Turistik të Specialitetit të vecantë”, në Shkresën nr.1828 prot. datë 17.07.2023 “Mbi kostot e realizimit të modulit Rafting”, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 17.10.2023,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të pikës 2, të nenit 7, të Vendimit të Bordit të Administrimit me nr. 35, datë 21.10.2019, si më poshtë vijon:
 - Të ardhurat e përfituara nga shërbimet e kryera të ndahen në masën 40 % personeli akademik, 10% stafi administrativ dhe 50% institucioni.
 - 10 % e të ardhurave që do të përdoret për trajtimin financiar të stafit administrativ të ndahet si më poshtë vijon: 5 % për Kordinatorin e Qendrës së Trajnimit të Vazhduar / Menaxhimin e kursit profesional të certifikimit të “Udhërrëfyesit Turistik të Specialitetit të Veçantë”, 3% për përgjegjësin teknik (IT) / administrim kursit, regjistrim dhe administrim i dokumentacionit të kursit profesional të certifikimit të “Udhërrëfyesit Turistik të Specialitetit të Veçantë” dhe 2% për administrimin financiarë.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të Universitetit të Sporteve të Tiranës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

P/ **ARTUR COBANI**

